



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.564/7 Prot.

Tiranë, më 04.12.2023

V E N D I M

Nr. 241, Datë 04.12. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar mori në shqyrtim ankesën Nr.69, datë 02.05.2023 të paraqitur znj. I.G kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, znj.I.G deklaron se është banore e qytetit të Korçës dhe kryefamiljare e ve, e vetmuar, pasi bashkëshorti i saj ka ndërruar jetë në vitin 2016. Ajo shpjegon se, jeton e vetme në një dhomë tek Konvikti i ish Bujqësore qe prej vitit 2001.

Znj.G informon se, ka një kontratë me Bashkinë Korçë dhe deri në vitin 2017 i ka paguar personit përgjegjës te Konvikti 1000 lekë për dritat dhe ujin. Nga viti 2018, është pa energji elektike për shkak të mosvendosjes së matësit, pasi OSHEE sh.a në këtë vit vendosi matësat për të gjithë banorët që jetojnë aty kundrejt një pagese. Ankuesja shpjegon se, për shkak të gjendjes ekonomike dhe shëndetësore të bashkëshortit nuk ka patur mundësi të paguajë matësin, dhe prej këtij viti e deri më sot është pa energji elektrike dhe se OSHEE sh.a i ka komunikuar se është debitore pasi duhet të paguajë taksat që vendosen në faturë. Ankuesja pretendon se mospasja e një kontrate me OSHEE sh.a e ka penalizuar që të përfitojë kompesimin e energjisë.

Znj. G informon se, jeton e vetme me 7900 lekë pension të përfituar nga bashkëshorti i ndjerë dhe nuk ka asnjë të ardhur tjetër. Ajo pretendon se është paraqitur pranë OSHEE sh.a për të zgjidhur situatën por përgjigja ka qenë se duhet të paguajë jo vetëm këto detyrime por edhe ato detyrime të

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

cilat sipas ankuseses ajo i ka paguar tek përfaqësuesi i institucionit, të cilat i provon nepërmjet mandatpagesave, të cilat OSHEE sh.a nuk i njeh.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri të vërtetojë se është diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike nga ana e OSHEE sh.a dhe të merren masa për vendosjen e matësit të energjisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (në vijim LMD), që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, rezultoi se, ankesa nuk plotësonte të gjitha kriteret formale për praninë, pasi nuk shoqërohej me dokumentacionin e nevojshëm për të bërë të mundur kryerjen e hetimit. Ankesa u plotësua me dokumentacionin e nevojshëm për të vijuar më tej procedurat e shqyrtimit në datën 18.05.2023, nëpërmjet Zyrës Rajonale Korçë, të Komisionerit.

Pas plotësimit të ankesës, në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 564/1 prot., datë 23.05.2023, Komisioneri kërkoi informacion nga OSHEE sh.a dhe OSHEE sh.a Korçë, në lidhje me pretendimet e ankuseses.

1.1 Në përgjigje të kësaj kërkese për informacion, me shkresën nr.4068/1 prot, datë 09.06.2023, OSHEE sh.a ktheu përgjigje, duke informuar Komisionerin si më poshtë:

Në vijim të njoftimit të dërguar nga Komisioneri është komunikuar me strukturat përgjegjëse të Shoqërisë FSHU sh.a dhe Shoqërisë OSSH sh.a, për sqarimin e problematikës së paraqitur. Sipas informacionit të përcjellë, OSHEE sh.a bën me dije se, nga konsultimi i të dhënave rezulton që znj. G nuk ka bërë asnjë aplikim, kërkesë apo ankesë pranë qendrave të Kujdesit ndaj Klientit, që nga viti 2016 e në vijim.

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë, ka miratuar me vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të Komisionerëve të ERE, e ndryshuar me vendimin Nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të Komisionerëve të ERE

“Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, të cilën mund ta konsultoni në faqen zyrtare të internetit të ERE https://www.ere.gov.al/doc/Rregullore_per_Lidhje_e_Reja.pdf.

OSHEE sh.a, shpjegon se, për realizimin e një lidhje të re znj. G duhet të paraqesë setin e dokumentacionit të përcaktuar në nenin 2.1 të Rregullores. Gjithashtu OSHEE sh.a sqaron se, neni 4.2 i kësaj Rregullore përcakton kostot që lidhen me shërbimet që do të kryhen nga OSHEE Group sh.a dhe se, referuar nenit 4.3, OSHEE Group sh.a zbaton praktikën e pagesës së plotë në avancë për të gjitha lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese.

Shoqëria OSHEE sh.a shprehet se, mirëkupton situatën me të cilën përballet znj.I.G si dhe shqetësimin e paraqitur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por siç është referuar edhe më sipër, Shoqëria OSHEE Group sh.a vendoset në pozitën e zbatimit të dispozitave të Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, sipas kushteve të përcaktuara në këtë akt rregullator, si çdo entitet tjetër shtetëror që ushtron veprimtarinë e vet në kushtet e rregullimit.

1.2 Me shkresën nr.87/1 prot, datë 05.06.2023, ka dërguar informacion edhe Drejtoria Rajonale Korçë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a (OSSH sh.a), nëpërmjet të cilës bëjnë me dije se:

Nga ana e OSSH Korçë u kryen verifikimet në sistem për abonentin I.G nga ku rezultoi se, nuk ka të regjistruar kontratë energjie elektrike. Për të kryer verifikime të mëtejshme, OSSH sh.a Korçë, deklaroi se ishte e nevojshme vendosja në dispozicion e kontratës së energjisë që mund të disponojë në emrin e saj ankuesja apo të ndonjë familjari të saj.

Gjithashtu, OSSH sh.a Korçë bëri me dije se, në rastin kur nuk do të disponohet asnjë kontratë energjie, abonenti duhet të kryejë aplikimin pranë Zyrrave të Kujdesit Ndaj Klientit për Lidhje të Re me energji elektrike.

2. Me shkresën nr.564/2 prot datë 31.07.2023, Komisioneri i'u drejtua OSSH sh.a, Drejtoria Rajonale Korçë, me një kërkesë për informacion në lidhje me situatën e znj. I.G, duke i vendosur njëkohësisht në dispozicion edhe aktet e depozituara nga pala ankuese, për kryerjen e verifikimeve më të detajuara. Konkretisht OSSH sh.a Korçë i'u kërkuar:

- A ka kontratë energjie elektrike në emër të klientit/abonentit me këto gjeneralitete: I.G, e datëlindjes 16.08.1964, me numër personal G45816028S?
- A figuron aktualisht debitore shtetasja me gjeneralitetet: I.G, e datëlindjes 16.08.1964, me numër personal G45816028S dhe nëse po, sa është ky detyrim?
- A ka ndonjë akt-marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike me këste në emër të klientit me këto gjeneralitete: I.G, e datëlindjes 16.08.1964, me numër personal G45816028S?
- Në emër të cilit klient/abonent figuron kontrata e furnizimit me energji elektrike KR0A060006025566? A figurojnë detyrime të papaguar të furnizimit me energji elektrike që rrjedhin nga kjo kontratë? Nëse po sa është ky detyrim dhe a ka akt-marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste?

OSSH sh.a, Drejtoria Rajonale Korçë, nuk ktheu përgjigje në lidhje me kërkesën e mësipërme për informacion.

3. Me shkresën nr.564/3 prot, datë 31.07.2023, Komisioneri i'u drejtua me një kërkesë për informacion në lidhje me rastin e znj.I.G Bashkisë Korçë, meqënëse sipas pretendimeve të ankueses ajo është e pastrehë dhe është sistemuar nga Bashkia Korçë pranë ish Konviktit të Bujqësores. Konkretisht Bashkisë Korçë i është kërkuar informacion në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Informacion në lidhje me situatën sociale dhe ekonomike që disponon Bashkia Korçë për znj. I.G.
- A është znj. I.G, përfituese e ndihmës ekonomike apo e ndonjë programi tjetër në kuadër të mbrojtjes sociale? Nëse po, prej sa kohësh është përfituese e ndihmës ekonomike apo programit të asistencës sociale?
- Informacion në lidhje me marrëdhënien kontraktuale që znj. I.G ka patur me Bashkinë Korçë, në lidhje me qëndrimin e saj pranë Konviktit të ish Bujqësores dhe mënyrës se si janë përmbushur detyrimet e energjisë elektrike nga ana e saj kundrejt Bashkisë Korçë.
- A disponon ndonjë informacion Bashkia Korçë në lidhje me situatën e furnizimit me energji elektrite të znj. I.G?

Në përgjigje të kësaj kërkesë, pranë Komisionerit janë administruar dy përgjigje, konkretisht:

3.1 Me shkresën nr.374 prot datë 03.08.2023, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë (NSHMAC), ka informuar se:

NSHMAC ka lidhur kontratë me z. Robert G në dt.01.11.2016. Në zbatim të kontratës, neni 3, pika 7, 8, është specifikuar plotësisht mënyra e pagesës së energjisë dhe ujit të pijshëm. Znj. I.G, bashkëshortja e z. Robert G, në bazë të informacionit të marrë nga OSHEE, nuk ka lidhur kontratë me OSHEE dhe si rrjedhim nuk ka detyrime të papaguara.

3.2 Me shkresën nr. 5914/ prot datë 07.08.2023, Bashkia Korçë, ka informuar se:

Lidhur me situatën sociale dhe ekonomike të znj.I.G sqarojmë se, është një familje e pastrehë, e cila aktualisht jeton e vetme, pranë ambienteve të Konviktit të Shkollës Bujqësore. Jeton me gjysmën e pensionit të bashkëshortit i cili ka ndëruar jetë.

Nga ana e bashkisë, znj. G ka qenë gjithmonë e përfshirë në trajtimin me paketa ushqimore, të cilat janë shpërndarë për banorët e Konviktit të Shkollës Bujqësore, në situata të ndryshme. Znj. G, është trajtuar me ndihmë ekonomike nga sistemi i pikëzimit për periudhën nëntor 2018 deri në gusht 2019, më pas ka patur një shpërndarje nga skema, me arsyen se nuk figuron e regjistruar si punëkërkuese tek Zyra e Punës për një periudhë 6 (gjashtë) mujore, bazuar në ligjin nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Pas përfitimit të pensionit të bashkëshortit

dhe këtij penaliteti zonja ka riaplikuar përsëri në sistemin e ndihmës ekonomike në muajin maj 2023 dhe është refuzuar nga sistemi, me arsyen se nuk ka marrë pikët e mjaftueshme. Për shkak të kriterëve të miratuara në Këshillin Bashkiak, znj. G nuk mund të trajtohet nga programet e tjera të ndihmës ekonomike. Nga ana e bashkisë i është ofruar çdo muaj mundësia për aplikim në sistemin e pikëzimit të ndihmës ekonomike, deri në momentin që do të dalë fituese.

4. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: “8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore. Nëpërmjet shkresës nr.564/4 prot datë 18.08.2023, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 30.08.2023. Në seancë dëgjimore përveç palës ankuese Shoqëria OSHEE sh.a, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, u ftuan për të marrë pjesë Bashkia Korçë, Shoqëria OSSH sh.a dhe Drejtoria Rajonale Korçë e OSSH sh.a.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 30.08.2023. Seanca u zhvillua në mungesë të palës ankuese, e cila nëpërmjet Zyrës Rajonale të Komisionerit në Korçë, njoftoi se nuk kishte mundësi që të ishte prezent si dhe të subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa Shoqërisë OSHEE sh.a, i cili nuk paraqiti ndonjë arsye për mospjesmarrjen. Në seancë u paraqit Shoqëria OSSH sh.a, e cila u përfaqësuar nga znj. A.T, e pajisur me autorizimin nr.8913 prot datë 28.08.2023, të lëshuar nga Administratori i OSSH sh.a. Në seancë dëgjimore nuk u paraqit Bashkia Korçë, e cila edhe pse ka marrë dijeni rregullisht për datën dhe orën e seancës, nuk paraqiti ndonjë arsye për mospjesmarrjen.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Shoqërisë OSSH sh.a theksoi se, kjo e fundit është shoqëri tregtare që vepron mbi bazën e rregullores të ERE-s. Çdo shtetas që kërkon të bëjë lidhje të re duhet të paguajë një tarifë dhe ankuesja nuk është trajtuar ndryshe nga të tjerët. Megjithatë shoqëria ishte e hapur, për zgjidhjen e problematikës brenda kompetencave të saj dhe se do të kryente verifikimet e nevojshme në lidhje me situatën e ankueses nëpërmjet strukturave të saj rajonale në Korçë.

5. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 27.09.2023, OSHEE sh.a, vendosi në dispozicion të Komisionerit informacionin e mëposhtëm:

Nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a (FSHU sh.a), me gjeneralitetet I.G nuk rezulton asnjë kontratë furnizimi me energji elektrike.

Kontrata me kod xxxxxxxxxxxx, rezulton të jetë me gjeneralitetet I.N.T me numër ID xxxxxxxxxxxx, numri i ID është i njëjtë me atë të znj. I.G. Kontrata me kod xxxxxxxxxxxx është nënshkruar akt marrëveshje në vitin 2015 dhe abonenti nuk ka respektuar pagesën e kësteve, duke kaluar statusi i saj i mbyllur. Pra kjo marrëveshje është prishur në mënyrë të njëanshme nga FSHU sh.a.

Aktualisht kjo kontratë rezulton të jetë me debi për periudhën shkurt 2007-gusht 2023. Nëse abonenti kërkon të nënshkruajë sërish akt marrëveshje për likuidimin e detyrimeve me këste, ju informojmë si më poshtë vijon:

- Abonenti mund të përfshihet në pagesë me këste për debinë deri në dhjetor 2021.
- Debia janar-gusht 2023 nuk mund të përfshihet në skemën e pagesës me këste.
- Skemat e Akt-marrëveshjes janë me 2800 lekë ose 1200 lekë këstin. Në skemat e Akt marrëveshjes me 1200 lekë këstin mund të përfshihet nëse klienti është familje që trajtohet me status në nevojë, pensionist ose status tetraplegjik/paraplegjik, nëse përfitohet një nga statutet duhet të shoqërohet me vërtetim.

6. Me shkresën nr.564/5 prot datë 16.10.2023, Komisioneri i'u drejtua Bashkisë Korçë duke kërkuar informacion në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- a) Informacion në lidhje me momentin kur znj. I.G është konstatuar nga Bashkia Korçë, si familje e pastrehë dhe çfarë masash janë marrë në vijim për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm për znj. G?
- b) Kur është strehuar znj. G në ambientet e Konviktit të Shkollës Bujqësore dhe çfarë procedurash janë ndjekur për strehimin e saj në këtë ambient?
- c) Kur iu është kërkuar familjeve të strehuara në ambientet e Konviktit të Shkollës Bujqësore, ku përfshihet edhe familja e znj. I.G, që të lidhin kontrata individuale për furnizimin me energji elektrike? Çfarë masash janë marrë nga ana e Bashkisë Korçë në lidhje me familjet, përfshi edhe familjen e znj. I.G, të cilat për shkak se nuk kanë patur mundësi financiare të lidhin kontratat dhe të vendosin matësit individualë të energjisë elektrike, nuk kanë mundur që të sigurojnë furnizimin me energji elektrike.
- d) Cilat janë arsyet e refuzimit të aplikimeve të ankueses për të përfituar ndihmën ekonomike, nga ana e sistemit të pikëzimit?

6.1 Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr.5914/3 prot datë 25.10.2023, Bashkia Korçë ktheu përgjigje, duke parashtruar si më poshtë:

Qytetarja I.G, është konstatuar si e pastrehë në momentin kur zona (Pazari i Vjetër) ku jetonte familja G, iu nënshtrua një rikonstruksioni të thellë dhe për shkak të investimeve me interes publik strehimi i saj në kushtet e mëparshme (një nga objektet në Pazarin e Ri), u bë i pamundur.

Me anë të një kontrate huapërdorje që mban datën 01.11.2016, midis Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes dhe qytetarit Robert G (i shoqi), u bë sistemimi i familjes në një objekt banimi të përkohshëm në Konviktin e Shkollës Bujqësore, Kati 2, dhoma nr.2, në të cilën vazhdon e vetme ta përdorë falas.

Në lidhje me masat që janë marrë në vazhdim për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, kësaj qytetareje i është dhënë gjithë informacioni për të përfituar nga programet e strehimit social që zbatohen në Bashkinë Korçë. Duke njohur kushtet dhe rrethanat e kësaj familje, bashkia i ka

sugjeruar që të sigurojë një banesë me kontratë qiraje sociale dhe kjo do të mund të ndryshojë dhe përmirësojë gjendjen e strehimit, si përfituese nga programi i “Subvencionit të qirasë”.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, ankuesja I.G, është e e datëlindjes 16.08.1964 dhe banon në qytetin e Korçës. Ajo jeton në një dhomë, në katin e 2-të, në një banesë kolektive dhe konkterisht pranë Konviktit të Shkollës Bujqësore në qytetin e Korçës. Bazuar në aktet e lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë, ankuesja është me gjendje civile “e ve” dhe është kryefamiljare e vetme.

Në lidhje me situatën sociale dhe ekonomike të ankuses, sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga Bashkia Korçë, rezulton se, ankuesja është një familje e pastrehë, e cila jeton aktualisht e vetme pranë ambienteve të Konviktit të Shkollës Bujqësore dhe jeton me pensionin e bashkëshortit i cili ka ndërruar jetë.

Referuar vërtetimit “*Për lloj dhe masë pensioni*” që mban datën 22.04.2023 dhe është vulosur elektronikisht nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), ankuesja përfiton që prej datës 16.08.2019 pension në masën 12953 lekë në muaj.

Po sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga Bashkia Korçë me shkresën nr.5914/1 prot datë 07.08.2023, ankuesja është trajtuar me ndihmë ekonomike gjatë periudhës nëntor 2018 deri në gusht 2019. Pas këtij momenti ankuesja ka patur një shkëputje nga skema e ndihmës ekonomike, me arsyen se nuk figuron e regjistruar si punëkërkuese tek Zyra e Punës për një periudhë 6 (gjashtë) mujore, bazuar në ligjin nr.57/2019 “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*”. Bashkia Korçë informoi se, ankuesja ka riaplikuar përsëri në sistemin e ndihmës ekonomike në muajin maj 2023, por është refuzuar nga sistemi, me arsyen se nuk ka marrë pikët e mjaftueshme, por pa specifikuar shkaku që e ka penalizuar ankuesen në mosmarrjen e pikëve. Nga ana e bashkisë theksohet fakti se, ankuses i është ofruar çdo muaj mundësia për aplikim në sistemin e pikëzimit të ndihmës ekonomike, deri në momentin që do të dalë fituese. Sipas bashkisë, në vazhdimësi ankuesja është trajtuar me paketa ushqimore të cilat janë shpërndarë për banorët e Konviktit.

Nga aktet e administruara nuk konstatohet qartësisht momenti kur ankuesja është strehuar pranë ambienteve të Konviktit të Shkollës Bujqësore. Ankuesja pretendon se, jeton në një dhomë tek Konvikti i Shkollës Bujqësore që prej vitit 2001, pasi banesa ku ka jetuar më parë ka qenë me pronar. Nga ana tjetër, Bashkia Korçë, nëpërmjet shkresës nr.5914/3 prot datë 25.10.2023, informoi se znj. G është konstatuar si e pastrehë në momentin kur zona (Pazari i Vjetër) ku jetonte familja G, iu nënshtrua një rikonstruksioni të thellë për shkak të investimeve me interes publike. Për këtë arsye, strehimi i saj në kushtet e mëparshme u bë i pamundur dhe me anë të një

kontrate huapërdorje që mban datën 01.11.2016, midis Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes dhe bashkëshortit të ankueses z. Robert G, u bë sistemimi i familjes në një objekt banimi të përkohshëm në Konviktin e Shkollës Bujqësore, Kati 2, dhoma nr.2, në të cilën ankuesja vazhdon e vetme ta përdorë falas.

Referuar kontratës së huapërdorjes të nënshkruar në datën 01.11.2016, midis bashkëshortit të ankueses z. R.G dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, pasqyrohet se, z. R.G, në kohën e lidhjes së kësaj kontrate ka qenë ish banor tek Poligoni/Hani i Gjelit. Në bazë të kësaj kontrate familjes së ankueses i është dhënë në përdorim të përkohshëm dhe pa kundërshtim një dhomë në katin e dytë të Konviktit të Shkollës Bujqësore në Korçë. Sipas nenit 4, pikat 7 e 8, të Kontratës së Huapërdorjes, përcaktohet se familja që ka marrë në huapërdorje ambinetin duhet të paguajë faturën e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm dhe se është e detyruar të lidhë kontratë me OSSHE dhe UKKO sh.a Korçë.

Ankuesja pretendon se, deri në vitin 2017, i paguanin detyrimet për dritat dhe ujin tek përgjegjësi i Konviktit, por nuk depozitoi ndonjë mandate pagesë ndërsa Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, në parashtrimet e saj para Komisionerit, pretendoi se pagesat janë kryer sipas parashikimeve në Kontratën e Huapërdorjes pa dhënë shpjegime në lidhje me pretendimin e ankueses. Prej vitit 2018 ankuesja pretendon se është pa energji elektrike për shkak të mosvendosjes së matësit të energjisë elektrike. Ankuesja pretendon se, në vitin 2018, OSHEE sh.a vendosi matësat për banorët që jetojnë pranë Konviktit të Shkollës Bujqësore kundrejt pagesës. Për shkak të gjendjes ekonomike dhe gjendjes shëndetësore të bashkëshortit, ankuesja shpjegon se nuk kishte mundësi të vendoste matësin.

Në bazë të akteve dhe informacionit të administruar rezultoi se, në emër të ankueses ka një kontratë ekzistuese për furnizimin me energji elektrike me kod nr. xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx. Kjo kontratë edhe pse figuron me gjeneralitete I.N.T, e ka ID e njëjtë me atë të ankueses I.N G. Nga të gjitha të dhënat e administruara rezulton se, kjo kontratë për furnizimin me energji elektrike i përket banesës në të cilën ankuesja ka jetuar përpara se të mbetej e pastrehë, pranë ish hanit të Gjelit, në Pazarin e ri të Korçës dhe të strehohej pranë Konviktit të ish Bujqësores.

Sipas vërtetimit me nr.439 prot datë 04.12.2017, të lëshuar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë, ankuesja znj.I.G, e njohur si huapërdorëse e dhomës nr.2, autozizohet që të transferojë kontratën e energjisë elektrike nga ish Hani i Gjelit dhe t'a vendosë matësin e energjisë elektrike në dhomën nr.2 në Konviktin e Shkollës Bujqësore. Rezulton se ankuesja nuk ka mundur që ta transferojë matësin e energjisë elektrike nga ish banesa ku ka jetuar tek Hani i Gjelit për tek Konvikti i Shkollës Bujqësore ku ajo është strehuar pasi ka mbetur e pastrehë dhe është zhvendosur nga vendbanimi i saj për shkak të investimeve publike në zonën e Pazarit të Ri në qytetin e Korçës.

Rezulton se, kontrata e energjisë elektrike që ankuesja ka patur në banesën e saj tek Hani i Gjelit, pavarësisht se ankuesja nuk jeton prej kohësh në këtë banesë, vazhdon të jetë e hapur. Për më

tepër kjo kontratë e energjisë elektrike figuron me detyrime të papaguar por jo vetëm, kjo kontratë e energjisë elektrike vazhdon të prodhojë detyrime, në formën e tarifës fikse të shërbimit edhe pse nuk ka konsum të energjisë elektrike. Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga OSHEE sh.a, konfirmohet fakti se kontrata me xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx (e cila edhe pse figuron me gjeneralitete I.N.T, numri i ID-së është i njëjtë me atë të znj. I.G) është kontratë me debi për periudhën shkurt 2007- gusht 2023. Sipas informacionit të OSHEE sh.a konfirmohet se për kontratën ka patur një akt marrëveshje në vitin 2015. Për shkak se abonenti nuk ka respektuar pagesën e kësteve, akt marrëveshja është mbyllur.

Referuar një akt marrëveshje të nënshkruar në datën 21.12.2016, rezulton se midis ankueses dhe OSHEE sh.a përfaqësuar nga strukturat e saj të Kujdesit ndaj klientit në Korçë është nënshkruar një amendim i akt marrëveshjes së vitit 2015. Në këtë moment rezulton se ankuesja ka kryer edhe një pagesë në vlerën 1220 lekë për detyrimin që i përket muajit janar 2017.

Referuar dokumentit “*Customer Payment Details*” i cili është gjeneruar në datën 13.10.2021 nga sistemi i OSHEE sh.a, rezulton se, që prej muajit janar 2017 deri në muajin gusht 2021, në mënyrë të pandërprerë, detyrimet konsistojnë tarifën fikse të shërbimit, taksat që paguhen nëpërmjet faturës së energjisë elektrike dhe kamatat respektive, pa patur asnjë konsum të energjisë elektrike për këtë kontratë.

Të gjitha aktet e depozituara nga ankuesja, i janë vendosur në dispozicion OSHEE sh.a dhe Bashkisë Korçë, për të kryer verifikime të detajuara në lidhje me situatën dhe pretendimet e ankueses. Dokumentacioni i depozituar nga ankuesja nuk u kundërshtua për sa i përket vërtetësisë, nga ana e këtyre subjekteve.

Ankuesja I.G ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike, pasi prej vitit 2018 ajo jeton pa energji elektrike sepse nuk ka mundësi financiare për të vendosur matësin e energjisë.

Ankuesja e ka drejtuar pretendimin e saj për diskriminim kundër OSHEE sh.a. Ajo pretendon se, verbalisht është paraqitur pranë OSHEE sh.a për të zgjidhur situatën, por përgjigja ka qenë se duhet të paguajë. Gjatë shqyrtimit nuk u administrua ndonjë kërkesë apo ankesë me shkrim që ankuesja ka bërë në lidhje me këtë çështje pranë strukturave të OSHEE sh.a.

Gjatë shqyrtimit të çështjes OSHEE sh.a, prapësoi pretendimin për diskriminim të ankueses, duke parashtruar se, znj. G nuk ka bërë asnjë aplikim, kërkesë apo ankesë pranë qendrave të Kujdesit ndaj Klientit. Në zbatim të Rregullore për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, të miratuar me Vendimin nr. 166, datë 10.10.2016 të Bordit të ERRE, e ndryshuar me Vendimin Nr.177, datë 08.11.2016 , të Bordit të ERRE, OSHEE sh.a parashtroi se, ajo zbaton praktikën e pagesës në avancë për të gjitha lidhjet e reja apo modifikimet e lidhjeve ekzistuese dhe për realizimin e një lidhje znj. G, duhet të paraqesë dokumentacionin sipas nenit 2.1 të Rregullores. OSHEE sh.a theksoi se, si çdo ent tjetër shtetëror që ushtron veprimtarinë e vet në kushtet e rregullimit

vendoset në pozitën e zbatimit të dispozitave të Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, sipas kushteve të përcaktuara në aktin rregullator të miratuar nga ERRE.

Pikat 4.2 dhe 4.3 të kësaj Rregulloreje, kanë të parashikuar procedurën lidhur me punimet dhe shërbimet që do të paguhen, si dhe mënyrën se si do të paguhen nga aplikanti, dhe konkretisht, lidhur me mënyrën e realizimit të pagesës, është përcaktuar se:

- Aplikanti duhet të kryejë një pagesë për tarifën e lidhjes së re, e cila mbulon shpenzimet e përcaktuara në këtë akt.
- Aplikanti duhet të mbulojë vetë shpenzimet e të gjitha punimeve dhe paisjeve shtesë që janë të nevojshme për të realizuar lidhjen e re.
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të zbatojë praktikën e pagesës së plotë në avancë për të gjitha lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese.

Komisioneri çmon të theksojë se, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij, për shqyrtimin e ankesave për diskriminim, ka trajtuar problematika të ngjashme, të paraqitur nga persona të cilët kanë pretenduar se janë vendosur në kushte diskriminuese, pasi për shkak të gjendjes ekonomike nuk kanë patur mundësi financiare të parapaguajnë tarifën për lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, të miratuar nga ERRE me Vendimin Nr.166, datë 10.10.2016 të Bordit të ERRE, të ndryshuar. Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri ka analizuar dhe shqyrtuar nëse akti rregullator, Rregullorja “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes” është diskriminuese ndaj personave të cilët për shkak të gjendjes së tyre ekonomike janë në pamundësi financiare për të realizuar pagesën e plotë dhe në avancë të lidhjes së re. Komisioneri ka konstatuar se, pika 4.3 e Rregullores “Për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, për lidhjen e Kontratës për Furnizimin me Energji Elektrike, diskriminon në mënyrë të tërthortë të gjithë ata aplikantë të cilët janë në pamundësi financiare për të paguar në avancë tarifën për lidhjen e re në vlerën prej 22.000 lekë. Komisioneri ka vlerësuar se, të gjithë aplikantët e ndodhur në kushtet e pamundësisë financiare për të realizuar pagesën për lidhjen e re, trajtohen njëjloj me aplikantët në mundësi financiare për ta realizuar atë, duke mos i përjashtuar ata nga detyrimi për kryerjen e saj; bën që automatikisht ata të mbeten të pafurnizuar me energji elektrike, duke çenuar rëndë jo vetëm përmbushjen e nevojave më minimale të një jetese normale të kësaj kategorie përfituesish, por edhe dinjitetin e tyre².

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, praktika që ndiqet nga OSHEE sh.a për pagesën e plotë në avancë për lidhjen e re apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese, është kërkesë që vjen si zbatim i drejtëpërdrejtë i aktit rregullator të këtij Operatori. Për sa kohë që Rregullorja e përcakton si detyruese një kërkesë të tillë, OSHEE sh.a është e detyruar ta zbatojë atë.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se OSHEE sh.a nuk ka konsumuar veprime ose mosveprime që ta kenë vendosur ankuesen në kushte diskriminuese për shkak të gjendjes së saj

² Vendimet Nr. 33, datë 07.04.2020 dhe Nr.34, datë 07.04.2020, të Komisionerit.

ekonomike e rrjedhimisht, nuk konstatohen shkelje të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar nga ana e këtij subjekti.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës së ankueses I.G, Komisioneri çmon se, pretendimet e ankueses se është diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike, pasi prej vitit 2018 ajo jeton pa energji elektrike, sepse nuk ka mundësi financiare për të vendosur matësin e energjisë duhet të vlerësohet dhe shqyrtohen edhe në kuadër të detyrimeve që ka pushtetit vendor në kuadër të ushtrimit dhe përmbushjes së funksioneve të tij në fushën e strehimit social, sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar (në vijim ligji nr.139/2015) dhe ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” (në vijim ligji nr. 22/2018), që në rastin konkret është Bashkia Korçë.

Rezulton e provuar se ankuesja I.G është banore e Bashkisë Korçë dhe ka mbetur e pastrehë për shkak të investimeve me interes publike, të kryera nga ana e bashkisë. Bashkia Korçë deklaroi gjatë shqyrtimit të ankesës se, si pasojë e zhvendosjes së ankueses dhe familjes së saj nga banesa për shkak të investimit me interes publik, e ka strehuar ankuesen dhe familjen e saj në një objekt banimi të përkohshëm në Konviktin e Shkollës Bujqësore, kati 2, dhoma nr.2, të cilën ankuesja vazhdon e vetme ta përdorë falas. Ankuesja pretendoi se banon në Konviktin e Shkollës Bujqësore që prej vitit 2001, fakt ky që nuk rezultoi i provuar nga aktet dhe informacioni i administruar. Sipas Bashkisë Korçë, strehimi i ankueses në ambientet ku ajo jeton edhe aktualisht është realizuar në datën 01.11.2016, në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Huapërdorjes.

Sipas nenit 24, të ligjit nr.139/2015, funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale, përfshijnë ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Në nenin 4, të ligjit nr. 22/2018, përcaktohet se:

“1. Strehimi konsiderohet i përshtatshëm për një individ dhe/ose familje atëherë kur garanton privatësinë, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet.

2. Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson:

a) hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

b) shërbime bazë, brenda mjedisit të banimit;

c) qëndrueshmëri dhe siguri nga rreziqe që burojnë nga veprimet ose mosveprimet njerëzore, faktorët natyrorë e klimaterikë;

ç) qasje në shërbimet publike, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve;”

Rezultoi e provuar se ankuesja në ambientin ku është strehuar nga Bashkia Korçë nuk furnizohet me energji elektrike, që sipas pretendimeve të znj. G, jetesa në mungesë të energjisë elektrike rezulton prej vitit 2018. Bashkia Korçë edhe pse iu kërkua informacion në lidhje me situatën e furnizimit me energji elektrike të ankueses e cila është një banore e pastrehë e cila është sistemuar

nga bashkia në ambientin e Konviktin e Shkollës Bujqësore, nuk e kundërshtoi pretendimin e ankueses për mungesën e furnizimit me energji elektrike dhe nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me ndonjë masë të ndërmarrë nga ana e Bashkisë për të siguruar furnizimin me energji elektrike të ankueses.

Bashkia Korçë pretendoi se, strehimi i ankueses në ambientin e Konviktit të Shkollës Bujqësore është i përkohshëm.

Sipas nenit 54 “*Strehët e përkohshme dhe rastet e përdorimit*” dhe nenit 55 “*Kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme*” përcaktohet se:

“Neni 54

Strehët e përkohshme dhe rastet e përdorimit

1. Strehët e përkohshme janë objekte ose pajisje që montohen dhe çmontohen lehtë dhe që shërbejnë për strehim të përkohshëm. Me strehim të përkohshëm kuptohet strehimi për një afat deri në dy vjet. Menjëherë me strehimin në strehët e përkohshme, përfituesit e këtij programi duhet të aplikojnë në programet e tjera sociale të strehimit.

2. Strehët e përkohshme shërbejnë për strehimin e:

a) refugjatëve;

b) individëve që zhvendosen nga vendbanimi për shkak të fatkeqësive natyrore a njerëzore;

c) individëve që zhvendosen për shkak të investimeve publike ose private dhe nuk përfitojnë kompensim, vetëm në ato raste kur njësisia e vetëqeverisjes vendore dëshmon se nuk disponon asnjë alternativë tjetër strehimi në kuadër të programeve të tjera të strehimit social;

ç) emigrantëve të rikthyer;

d) personave të pastrehë, që banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim.

Neni 55

Kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme

1. *Strehët e përkohshme vendosen në vende të përshtatshme, të pastra e të sigurta nga përmbytjet dhe rreziqe të tjera.*

2. *Strehët e përkohshme sigurojnë mbrojtjen e duhur nga kushtet atmosferike. Zonat në të cilat instalohen strehët e përkohshme duhet të jenë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme, tualete dhe dushe.*

3. *Kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për strehimin.”*

Në bazë dhe për zbatim të dispozitës së mësipërme është miratuar Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 33 datë 26.8.2020 “Për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme”. Në këtë udhëzim, ndër të tjera, bëhen përcaktimet e mëposhtme:

“2. Strehët e përkohshme përdoren në përputhje me ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”. Normat, kushtet teknike, standardet e strehimit dhe të ndërtimit dhe vendndodhjet e strehëve të përkohshme të strehimit social respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dinjitetin njerëzor dhe integritetin e përfituesve, parimin e mosdiskriminimit, atë të përshtatjes me nevojat e veçanta dhe kushtet shëndetësore, sigurinë, higjienën, sigurojnë hapësirat bazë dhe mbrojtje nga kushtet klimatike dhe atmosferike, si dhe krijojnë mundësinë e përfitimit të aksesit në shërbime komunitare dhe të një jete komunitare.

6. Strehët e përkohshme duhet të ndërtohen, në zona që:

a) janë të pastra nga ndotja e ajrit, ndotja e tokës apo forma të tjera që përbëjnë rreziqe shëndetësore, kërcënime dhe rreziqe natyrore ose njerëzore, sipas legjislacionit në fuqi mbi mbrojtjen civile, mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e ajrit në mjedis;

b) janë të ekspozuara ndaj rrezatimit diellor;

c) nuk janë të ekspozuara ndaj kushteve ekstreme klimatike;

ç) respektojnë legjislacionin në fuqi lidhur me ekspozimin ndaj nivelit të zhurmave;

d) ofrojnë akses të automjeteve, furnizim me ujë dhe energji elektrike;”

Sipas nenit 54, të ligjit nr.22/2018, strehimi i përkohshëm nuk mund të zgjasë më shumë se dy vjet. Ankuesja I.G, nëse do të pranohet pretendimi i bashkisë Korçë se është strehuar në mënyrë të përkohshme në ambientet e Konviktit të Shkollës Bujqësore në datën 01.11.2016 kur është nënshkruar Kontrata e Huapërdorjes, që prej këtij momenti kanë kaluar më shumë se dy vjet, dhe ankuesja duhet të kishte aplikuar në programet e tjera sociale të strehimit. Bashkia Korçë pretendoi por nuk provoi se nga ana e saj ishin ezauruar të gjitha mundësitë dhe ankueses i është dhënë ndihmë dhe mbështetje efektive në mënyrë që ajo të përmirësonte gjendjen e strehimit për të përfituar nga programe të tjera në kuadër të strehimit social.

Megjithatë, në kushtet kur ankuesja ka vazhduar të jetojë në ambiente që vetë Bashkia Korçë i konsideron si një zgjidhje e përkohshme strehimi për personat e pastrehë, Bashkia Korçë nuk i ka siguruar ankueses një strehim të përshtatshëm, për shkak se ankueses i ka munguar furnizimi me energji elektrike. Pavarësisht faktit që godina ku është strehuar ankuesja mund të ofrojë akses ndaj furnizimit me energji elektrike, për shkak të pamundësisë financiare ankuesja e ka patur të pamundur që të sigurojë një kontratë për furnizim me energji elektrike, për shkak të detyrimit të vendosur në aktin rregullator të ERE sipas të cilit të gjithë abonentën duhet të paguajnë në avancë tarifën për lidhje të re ose modifikimin e një lidhje ekzistuese.

Përfundimisht sa më sipër, rezulton se ankuesja I.G e cila është konstatuar e pastrehë për shkak të investimit publik, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfatorshëm pasi nuk i është siguruar një strehim i përshtatshëm si pasojë e mungesës së energjisë elektrike, nga ana e Bashkisë Korçë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të gjendjes ekonomike, të pretenduar nga ankuesja si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike**, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” Komisioneri gjykon se “gjendja ekonomike” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD. Gjendja ekonomike, si shkak i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton në shumë fusha të jetës.

Rezulton se ankuesja I.G është e identifikuar nga Bashkia Korçë si familje në pamundësi ekonomike. Ankuesja është trajtuar me ndihmë ekonomike për periudhën nëntor 2018-gusht 2019 dhe më pas ka patur një shkëputje nga skema jo për shkak të përmirësimit të kushteve ekonomike por si pasojë e një penalizimi administrativ (mosregjistrimi në Zyrën e Punës si punëkërkuese e papunë). Nuk ka informacion se me çfarë të ardhurash mund të ketë siguruar jetesën ankuesja për periudhat kur ajo nuk ka përfituar nga sistemi i ndihmës ekonomike. Ndërsa prej datës 16.11.2019, rezulton se ankuesja ka si burim të ardhurash pensionin që përfiton nga bashkëshorti i cili ka ndërruar jetë, i cili të paktën sipas vërtetimit të datës 22.04.2023, të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore është në vlerën 12953 lekë në muaj. Me të ardhurat e saj ankuesja nuk ka qenë dhe vazhdon të mos jetë në gjendje që të paguajë në avancë tarifën e kërkuar nga operatori i energjisë elektrike në mënyrë që të sigurojë furnizimin me energji elektrike.

Sa më sipër, Komisioneri konsideron të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të gjendjes ekonomike.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Neni 18, i Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, sanksionon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”*. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës,

duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021).

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.” Ky ligj parashikon disa forma nëpërmjet të cilave mund të shfaqet sjellja diskriminuese, duke përcaktuar në nenin 3, pika 7, se : “7.

“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.”

LMD, është një ligj i cili është miratuar mbështetur dhe në zbatim të nenit 18 të Kushtetutës. Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit ose dështim për të trajtuar ndryshe, konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Sa më sipër rezulton se gëzimi dhe ushtrimi në të njëjtën mënyrë me të tjerët i të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe çdo të drejtë tjetër që buron nga ligjet në fuqi, garantohet duke eliminuar diskriminimin formal dhe atë substancial. Diskriminimi mund të rezultojë jo vetëm nga trajtimi i ndryshëm i njerëzve në situata të njëjta (diskriminimi formal), por gjithashtu duke ofruar të njëjtin trajtim për njerëzit në situata të ndryshme (diskriminimi substancial). Ky i fundit quhet diskriminim “i tërthortë”, sepse nuk është trajtimi që ndryshon, por janë më tepër pasojat e atij trajtimi, që do të ndjehen ndryshe nga njerëzit me karakteristika të ndryshme. Referuar përkufizimit ligjor elementët diskriminimit e tërthortë janë si më poshtë:

- një dispozitë, kriter apo praktikë në dukje neutrale;
- që prek një grup të përcaktuar nga një “shkak i mbrojtur” në një mënyrë shumë më negative;
- duke krahasuar të tjerët në një situatë të ngjashme.

Kriteri i parë i identifikueshëm është një dispozitë, kriter ose praktikë neutrale. Me fjalë të tjera, duhet të ketë një kriter që zbatohet për të gjithë. Në rastin konkret, në pamje të parë Bashkia Korçë nuk e ka trajtuar ankuesen ndryshe apo në mënyrë më pak të favorshme se personat e tjerë të pastrehë të cilët janë strehuar në të njëjtat ambiente sikurse ankuesja.

Kriteri i dytë i identifikueshëm është se dispozita, kriteri ose praktika neutrale e vendos një “grup të mbrojtur” në një disavantazh të caktuar. Për këtë arsye diskriminimi i tërthortë ndryshon nga diskriminimi i drejtpërdrejtë sepse e zhvendos fokusin larg nga trajtimi i ndryshëm për të parë efektet e ndryshme. Ankuesja është në pamundësi financiare për shkak të gjendjes së saj ekonomike, për të bërë në avancë pagesën e kërkuar nga operatori i energjisë elektrike që do t'i mundësonte asaj furnizimin me energji elektrike në ambientin ku është strehuar nga ana e Bashkisë Korçë. Në këtë mënyrë gjendja ekonomike e ankueses e vendos atë në kushte të

disfavorshme duke i pamundësuar furnizimin me energji elektrike, krahasimisht me personat e tjerë që nuk janë në pamundësi ekonomike.

E drejta për energji elektrike nuk është thjesht një shërbim. E drejta për energji elektrike në vetvete është një e drejtë themelore e njeriut, që buron nga e drejta për një standard të përshtatshëm jetese. Një nga referencat e para për të është në nenin 25 (1) të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i konsideruar gjerësisht si instrumenti kryesor për mbrojtjen e të drejtës për strehim të përshtatshëm, i referohet të drejtës së secilit për një standard të duhur jetese për vete dhe familjen e tij, përfshirë ushqimin, veshjen e përshtatshme dhe strehimin, dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës (neni 11). Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ka theksuar se, e drejta për strehim të përshtatshëm nuk duhet të interpretohet ngushtë. Përkundrazi, duhet parë si një e drejtë për të jetuar në siguri, paqe dhe dinjitet. Karakteristikat e së drejtës për strehim të përshtatshëm sqarohen kryesisht në Komentin e Përgjithshëm nr.4 (1991) mbi të drejtën për strehim të përshtatshëm dhe nr.7 (1997) mbi dëbimet e detyrueshme, të këtij komiteti. Strehimi i përshtatshëm, duhet të sigurojë më shumë se katër mure dhe një çati. Duhet të plotësohen një numër kushtesh të veçanta të strehimit, që të mund të flasim për "strehim të përshtatshëm". Sipas këtyre kriterëve, strehimi nuk është i përshtatshëm, nëse banorët e tij nuk kanë ujë të pijshëm të sigurt, kanalizime të përshtatshme, energji për gatim, ngrohje, ndriçim, ruajtjen e ushqimit ose hedhjen e mbeturinave.

Të drejtat e njeriut janë të ndërvarura, të pandashme dhe të ndërlidhura. Me fjalë të tjera, shkelja e të drejtës për strehim të përshtatshëm mund të ndikojë në gëzimin e shumë të drejtave të tjera të njeriut dhe anasjelltas. Qasja në strehim të përshtatshëm mund të jetë parakusht për gëzimin e disa të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për punë, shëndetësi, arsim, sigurime shoqërore, të drejtën për të votuar dhe atë për jetën private dhe familjare.

Energjia elektrike është një komponent kryesor dhe thelbësor i strehimit të përshtatshëm, prandaj të jetosh në ditët e sotme pa energji elektrike e bën jetën e secilit të vështirë ose ekstremisht të pamundur. Qasja ndaj energjisë elektrike është një parakusht i pashmangshëm për një strehim të përshtatshëm dhe njëkohësisht është thelbësor për garantimin e të drejtave të tjera, duke siguruar gjithashtu uljen e varfërisë. Mungesa e qasjes ndaj energjisë elektrike është njëkohësisht pasojë e varfërisë, por edhe një nga shkaktarët e saj.

Në kuadër të Këshillit të Evropës, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Karta Sociale Europiane nuk i referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtës për energji elektrike, por në jurisprudencën e GJEDNJ, mbrojtja e saj ka ardhur si rezultat i gëzimit të të drejtave të tjera të njeriut. Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut në rastin *Pocasovschi dhe Mihaila kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë* (Kërkesa nr.1089/09) ka vendosur që mungesa e energjisë elektrike, është shkelje e të drejtave të njeriut, pikërisht të neneve 3 dhe 8 të Konventës. Në këtë çështje gjykata arriti në përfundimin se, burrat e ndaluar në burg pa ujë, energji dhe ngrohje ishin mbajtur në kushte çnjerëzore.

Kushtetuta e Shqipërisë nuk e parashikon të drejtën për strehim në katalogun e të drejtave por në nenin 59 të saj, nën rubrikën “Objektivat socialë”, duke parashikuar që Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon “plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim”, si dhe “standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm”. Gjithashtu, po e njëjta dispozitë parashikon që “*Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave*”. Në këtë kuptim, objektivat socialë për t’u realizuar kanë nevojë për miratimin e ligjeve të posaçme, të cilat në parashikimet e tyre njohin njëkohësisht edhe të drejta që bëhen të detyrueshme për zbatim. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin nr. 22/2018 “*Për strehimin social*”, i cili ka përkufizuar konceptin “*strehim i përshtatshëm*”, që duhet të garantojë jetën private, një jetesë të sigurtë, të qetë dhe me dinjitet. Si një nga kushtet thelbësore sipas këtij ligji për një strehim të përshtatshëm është qasja “*në shërbimet publike, si: furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve*”.

E drejta për strehim të përshtatshëm, ku përfshihet e drejta për të patur energji elektrike, është një e drejtë themelore e njeriut. Si e tillë, shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë akses në energji elektrike, e për rrjedhojë do të jenë përherë në kushtet e një strehimi të papërshtatshëm.

Në rastin konkret, Bashkia Korçë, si njësi e vetëqeverisjes vendore në fushën e kompetencës të të cilës përfshihen çështjet e strehimit social dhe si njësi e vetëqeverisjes vendore në juridiksionin e të cilës është banore ankuesja I.G, ka detyrimin për të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme për të siguruar që ankuesja të gëzojë në mënyrë efektive kushte të përshtatshme strehimi, ku përfshihet edhe e drejta për t’u furnizuar me energji elektrike.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit rregullohet nga neni neni 33, pika 7/1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “*7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.*”

Sa më sipër, ankuesja duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.³

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë *trajtim të mundshëm diskriminues* dhe *ekzistencës së këtij trajtimi në realitet*. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, *duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim*.

Në aspektin procedural, si fillim duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, ankuesja I.G, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm pasi nuk i është siguruar një strehim i përshtatshëm, si pasojë e mungesës së energjisë elektrike, nga ana e Bashkisë Korçë.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (diskriminimi *prima facie*) se në pamje të parë ankuesja I.G, është diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike, në të drejtën për një strehim të përshtatshëm, për shkak të mungesës së energjisë elektrike. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, Bashkisë Korçë, i kalon barra e provës për të provuar se, trajtimi të cilit i është nënshtruar znj. ankuesja, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Të drejtat dhe liritë duhet të garantohen jo vetëm *de jure*, por edhe *de facto*, pra të sigurohet gëzimi në mënyrë efektive nga ana e personave. Strehimi i ankueses në ambientet e Konviktit të Shkollës Bujqësore pa siguruar që ankuesja të ketë furnizim me energji elektrike nuk mund të konsiderohet përmbushje efektive e të drejtës për të patur një strehim të përshtatshëm.

Bashkia Korçë, mbajti një qëndrim të drejtëpërdrejtë në lidhje me dijeninë e saj mbi kushtet e furnizimit të ankueses me energji elektrike, por nuk e kundërshtoi pretendimin e ankueses se ajo ka akses në energji elektrike në ambientin ku është sistemuar nga ana e kësaj bashkie.

Komisioneri vlerëson se, është në detyrimin e njësisë së vetëqeverisjes vendose, në rastin konkret Bashkisë Korçë, që të sigurojë duke marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme që personat

³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

e pastrehë të strehuar nga ana e saj të jetojnë në kushte të përshtatshme, përfshi këtu furnizimin me energji elektrike.

Kushtet e strehimit të personave të pastrehë në banesën kolektive, sikurse është Konvikti i Shkollës Bujqësore, nuk është një problematikë e panjohur për Bashkinë Korçë. Rezulton se në këtë ambient janë strehuar familje të pastreha që i përkasin grupeve shoqërore vulnerabël sikurse janë pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane⁴. Ankuesja nuk ka ngritur pretendime për diskriminim për shkak të etnisë. Gjithashtu, edhe Komisioneri ka trajtuar më parë problematika që lidhen me strehimin e personave të pastrehë që janë strehuar nga Bashkia Korçë në ambientet e Konviktit të Shkollës Bujqësore, dhe ka konstatuar se me anë të mosveprimeve, Bashkia Korçë ka sjellë trajtimin e pafavorshëm dhe të pabarabartë të banorëve të Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë për shkak të kushteve të papërshtatshme të strehimit në këtë ambient⁵.

Për sa kohë që Bashkia Korçë nuk ka arritur të sigurojë përmirësimin e kushteve të strehimit të ankueses duke e përfshirë atë në programe të tjera të strehimit social, ajo ka detyrimin që të sigurojë të gjitha kushtet e një strehimi të përshtatshëm në ambientet e Konviktit të Shkollës Bujqësore që i konsideron si zgjidhje e përkohshme. Bashkia Korçë, nuk arriti të tregojë se çfarë veprimesh konkrete kishte ndërmarrë për të përmirësuar situatën e strehimit të ankueses.

Në kushtet kur, ankuesja për shkak të gjendjes ekonomike ka qenë në pamundësi financiare për të lidhur një kontratë për furnizimin me energji elektrike në ambientin ku është strehuar si e pastrehë nga ana e Bashkisë Korçë, kjo e fundit ka patur detyrimin që të marrë masa pozitive në mënyrë që t'i mundësonte ankueses akses në furnizimin me energji elektrike, me qëllim sigurimin e një strehimi të përshtatshëm.

Në bazë të fakteve dhe provave të administruara, Komisioneri vlerëson se në mënyrë të pajustificuar dhe për një kohëzgjatje të konsiderueshme Bashkia Korçë nuk ka ndërmarrë asnjë përpjekje për të bërë të mundur që ankuesja të furnizohet me energji elektrike, në kushtet kur është në detyrimin e saj si njësi e vetëqeverisjes vendore që të jetë në dijeni të situatës së ankueses si person i pastrehë i strehuar në mënyrë të përkohshme nga ana e kësaj Bashkie.

Në lidhje me mënyrën dhe mjetet më të përshtatshme për të zgjidhur situatën e furnizimit me energji elektrike të ankueses në ambientin ku ajo jeton pranë Konviktit të Shkollës Bujqësore, Komisioneri gjykon se ato duhet të vlerësohen nga ana e vetë Bashkisë.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të administruara në lidhje me rastin e ankueses I.G, Komisioneri vlerëson se Bashkia Korçë dështoi që të jepte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, se trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë nuk ka ardhur si pasojë e gjendjes ekonomike të ankueses.

⁴ Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022, Bashkia Korçë.

⁵ Vendimi Nr.252, datë 18.12.2018, i Komisionerit.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja I.G është diskriminuar në të drejtën për strehim të përshtatshëm, në formën e diskriminimit të tërthortë, për shkak të gjendjes ekonomike, si rezultat i dështimit të Bashkisë Korçë për të marrë të marrë masa pozitive për të mundësuar furnizimin me energji elektrike të ankueses. Për rrjedhojë Bashkia Korçë, ka shkelur ndalimin e diskriminimit, të parashikuar nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. Ky ligj në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktime të diskriminimit ose parandalimin e situatave diskriminuese. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur në funksion të rregullimit të situatës diskriminuese të konstatuar ndaj ankueses I.G është marrja e masave të menjëhershme nga ana e Bashkisë Korçë për të mundësuar lidhjen e energjisë elektrike në ambientin ku ankuesja është strehuar, pranë Konviktit të Shkollës Bujqësore, Korçë. Me qëllim parandalimin në të ardhmen të situatave të ngjashme diskriminuese, Bashkia Korçë duhet të marrë masa për të përcaktuar dhe rregulluar, mënyrën se si duhet vepruar për kategorinë e personave të pastrehë që janë në të njëjtat kushte me ankuesen, të cilët për shkak të gjendjes së tyre ekonomike janë në pamundësi financiare për të siguruar lidhjen e energjisë elektrike.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11, 12 dhe 13, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të ankueses I.G në të drejtën për strehim të përshtatshëm, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Korçë.
2. Bashkia Korçë, duhet të marrë masa të menjëhershme për të mundësuar lidhjen e energjisë elektrike në ambientin ku ankuesja është strehuar, pranë Konviktit të Shkollës Bujqësore, Korçë.

3. Bashkia Korçë duhet të marrë masa për të përcaktuar dhe rregulluar mënyrën se si duhet vepruar për kategorinë e personave të pastrehë që janë në të njëjtat kushte me ankuesen, të cilët për shkak të gjendjes së tyre ekonomike janë në pamundësi financiare për të siguruar furnizimin me energji elektrike.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Bashkia Korçë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses I.G nga ana e Shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja ekonomike
Fusha: Të mira dhe shërbime/Strehim
Lloji vendimit: Diskriminim i tërthortë